EKZEKUTIMIT TË VENDIMEVE PENALE PËR TË MITUR**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 117, pika 7, të ligjit nr. 37, datë 30.3.2017 “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur”, të nenit 7, pika 2 të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar; të nenit 18 të ligjit nr. 69/2012, datë 21.6.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” ndryshuar; dhe nenit 37 të ligjit nr. 8328, datë 16.4.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve” i ndryshuar,

URDHËROJMË:

1. Miratimin e rregullave për zhvillimin e procesit arsimor në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale, sipas tekstit bashkëlidhur dhe që është pjesë përbërëse e këtij urdhri.
 2. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe Njësitë Arsimore Vendore për zbatimin e këtij urdhri.
 3. Ngarkohen Sekretarët e Përgjithshëm për ndjekjen e zbatimit të këtij urdhri.
- Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

Etilda Gjonaj (Saliu)

MINISTRI

Lindita Nikolla

**RREGULLIMI I PROCESIT ARSIMOR NË INSTITUCIONET E
EKZEKUTIMIT TË VENDIMEVE PENALE PËR TË MITUR**

KREU I RREGULLA TË PËRGJITHSHME

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i këtyre rregullave është të sigurojnë arsimimin bazë të detyrueshëm dhe sipas rastit edhe arsimim e mesëm dhe/ose të lartë, aty ku kushtet e lejojnë për të të miturit/të rinjtë e vendosur në mjediset e institucionit të paraburgimit dhe/ose në institucionin e ekzekutimit të vendimeve penale për të mitur (në vijim “institucionit të paraburgimit/IEVP”).

Neni 2 Objekti

Objekt i rregullave është përcaktimi i mënyrës dhe metodologjisë së nevojshme për zhvillimin e procesit mësimor, si dhe përcaktimi i detyrave për strukturat përgjegjëse për zhvillimin dhe mbarëvajtjen e procesit mësimor për të miturit/të rinjtë e moshës shkollore të vendosur në mjediset e institucionit të paraburgimit/IEVP.

Neni 3 Parimet e zhvillimit të procesit mësimor

1. Procesi mësimor për të miturit e vendosur në mjediset e institucionit të paraburgimit/IEVP është në përputhje me standardet e shërbimit të arsimit në Republikën e Shqipërisë të përcaktuara nga Kushtetuta dhe legjislacionin në fuqi.
2. Çdo i mitur që ndodhet në mjediset e institucionit të paraburgimit/IEVP ka të drejtë të arsimohet në përshtatje me nevojat dhe aftësitë e tij duke u bazuar në programe dhe plane mësimore që synojnë riintegrimin dhe aftësimin për të marrë një rol konstruktiv në shoqëri pas lirim.
3. Të paraburgosurit dhe/ose të dënuarit të mitur i sigurohet arsimi bazë i detyrueshëm dhe, sipas rastit, edhe arsimi i mesëm dhe/ose i lartë.
4. Arsimimi i të miturit kur zhvillohet në mjediset e institucionit të paraburgimit/IEVP, është në përputhje me kurrikulën e arsimit parauniversitar dhe realizohet përmes programeve dhe moduleve

mësimore për individët e moshës shkollore, të cilat hartohen në mënyrë që të sigurojnë vijimësinë e shkollimit të tij pas lirimt.

5. Struktura e vitit shkollor që zhvillohet në mjediset e institucionit të paraburgimit/IEVP është e njëjtë me atë të parashikuar për institucionet arsimore publike.

6. Procesi mësimor në mjediset e institucionit të paraburgimit/IEVP drejtohet nga mësues të kualifikuar.

7. Asnjë masë disiplinore e marrë sipas dispozitave të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur (këtu e në vijim “KDPM”) nuk mund të pengojë të miturin nga realizimi i programit mësimor.

8. Të drejtat dhe detyrimet për ndjekjen e procesit mësimor nga të miturit në mjediset e institucionit të paraburgimit/IEVP janë të njëjta me të drejtat dhe detyrimet e nxënësve në institucionet arsimore publike.

9. I paraburgosuri/i dënuari i mitur mund të punojë në përputhje me detyrimet e parashikuara në Kodin e Punës dhe në legjislacionin në fuqi për punësimin e të miturve, vetëm nëse një gjë e tillë nuk pengon arsimimin e tij, lehtëson edukimin profesional dhe punësimin e tij pas lirimt.

10. Institucioni i paraburgimit/IEVP dhe personeli mësimdhënës nxit partneritetin Shkollë-Familje për një proces mësimor të suksesshëm.

Neni 4

Legjislacioni i zbatueshëm

1. Në kuadër të mirëfunksionimit të sistemit të drejtësisë penale për të miturit, trajtimi dhe edukimi duhet të zhvillohet me qëllim përmirësimin e njohurive në respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut sipas standardeve ndërkombëtare dhe vendase.

2. Arsimimi i të miturve në konflikt me ligjin mbështetet në parimet kushtetuese, në Konventën për të Drejtat e Fëmijës lidhur me të drejtën për arsim, si dhe në legjislacionin shqiptar në fuqi që normon të drejtat e të miturve/të rinjve për arsimim.

Neni 5

Përshtatja e arsyeshme

1. Të paraburgosurit dhe/ose të dënuarit të mitur që kanë vështirësi të të mësuarit ose të nxënësve ose të tjera vështirësi që lidhen

me aftësinë e kufizuar, trajtohen me plane edukimi individuale.

2. Të njëjtat rregulla zbatohen edhe për të paraburgosurit dhe/ose të dënuarit e mituri që nuk kanë ndjekur asnjë klasë në institucionet arsimore parauniversitare.

Neni 6

Nxjitja dhe motivimi i të miturve për zbatimin e programit mësimor

Punonjësit e institucionit të paraburgimit/IEVP-së dhe njësitë arsimore vendore marrin masa të inkurajojnë dhe motivojnë të miturit për të ndjekur dhe për të marrë pjesë aktivisht në programet dhe veprimtaritë mësimore me qëllim aftësimin e tyre dhe riintegrimin e shpejtë pas përfundimit të periudhës së paraburgimit dhe/ose dënimit.

KREU II

RREGULLA PËR ZHVILLIMIN E PROCESIT MËSIMOR JASHTË MJEDISEVE TË INSTITUCIONIT TË PARABURGIMIT/IEVP

Neni 7

Arsimimi dhe trajnimi profesional në mjediset e institucioneve arsimore publike

1. Për të paraburgosurit/të dënuarit e mitur merren masa dhe vlerësohen mundësitë e organizimit dhe ndjekjes së procesit mësimor në mjedise të institucioneve arsimore publike jashtë mjediseve të institucionit të paraburgimit/IEVP.
2. Drejtuesit e institucionit të paraburgimit/IEVP dhe të njësive arsimore vendore marrin masa për nxitjen e praktikave të parashikuara në pikën 1 të këtij neni.
3. Drejtuesit e institucionit të paraburgimit/IEVP dhe të njësive arsimore vendore janë përgjegjës për frekuentimin, zhvillimin, mbarëvajtjen dhe monitorimin e procesit mësimor në mjediset e institucioneve arsimore publike.

Neni 8

Regjistrimi në institucionin arsimor dhe transporti

1. Drejtuesi i institucionit të paraburgimit/IEVP-së përgatit listën emërore të të miturve të paraburgosur dhe/ose të dënuar për të ndjekur procesin mësimor pranë institucionit arsimor të përcaktuar nga njësia arsimore vendore.
2. Drejtuesi i institucionit të paraburgimit/IEVP-së në bashkëpunim me drejtuesin e njësive arsimore vendore marrin masa për të garantuar regjistrimin e të miturve në institucionin arsimor publik pranë institucionit të paraburgimit/IEVP-së në klasat përkatëse.
3. Përcaktimi i klasës që do të frekuentohet nga i mituri bëhet mbi bazën e dokumentacionit të mbarimit të klasës paraardhëse. Në mungesë të këtij dokumentacioni realizohet një testim paraprak për vlerësimin e njohurive dhe përcaktimin e klasës. Njësia arsimore vendore në bashkëpunim me drejtuesin e institucionit arsimor krijon një komision të posaçëm për zhvillimin e testimit të njohurive të të miturit.
4. Shoqërimi i të miturve për në mjediset e institucionit arsimor sigurohet nga institucioni i paraburgimit/IEVP mbi bazën e rregullave

të posaçme të hartuara për lëvizjet e të miturve me qëllim zhvillimin e procesit mësimor.

KREU III RREGULLAT E PROCESIT MËSIMOR NË INSTITUCIONIN E PARABURGIMIT/IEVP

Neni 9

Programi mësimor, plani mësimor dhe personeli mësimor

1. Për të miturit e paraburgosur dhe/ose të dënuar zbatohet programi mësimor gjithëpërfshirës, duke mbajtur në konsideratë se:
 - a) kohëzgjatja vjetore e procesit mësimor caktohet në bazë të udhëzimit përkatës të vitit shkollor;
 - b) kohëzgjatja ditore e procesit mësimor deri në 6 (gjashtë) orë mësimore për të miturit në klasat VII - XII dhe deri në 5 (pesë) orë mësimore në ditë për të miturit në klasën VI dhe më ulët.
2. Për plotësimin e nevojave individuale të të miturve, personeli mësimdhënës përditësohet me nivelin e njohurive dhe dijeve të të miturit përmes marrjes së informacionit prej institucionit arsimor të ndjekur nga i mituri, si edhe drejtpërdrejt nga i mituri.
3. Të miturit e paraburgosur dhe/ose të dënuar përfshihen në programin mësimor pas një vlerësimi paraprak të nivelit të tyre jo më vonë se 3 ditë nga vendosja në institucionin e paraburgimit/IEVP.
4. Njësitë arsimore vendore kanë detyrimin të përcaktojnë nevojën dhe të ofrojnë program të përshtatur në rast të mungesës së njohurive dhe të aftësive për të shkruar dhe për të lexuar.
5. Procesi mësimor zhvillohet në ambiente të posaçme, të përshtatura në klasa, që vihen në dispozicion nga institucioni i paraburgimit/IEVP-së.
6. Për të miturit që për arsye shëndetësore nuk mund të ndjekin programin mësimor në klasë, zbatohen rregullat e arsimimit të pandërprerë derisa të kthehen përsëri në klasë dhe të merren masa për kthimin e tij në kohë të shpejtë në ambientin e klasës.
7. Sipas rastit, të miturit përfshihen në kurse të posaçme për të mundësuar dhënien e provimeve kombëtare.

Neni 10

Harmonizimi i programit mësimor me programet e tjera brenda planit individual

1. Të miturve të paraburgosur dhe/ose të dënuar u ofrohet një plan edukativ individual në përputhje me programin e plotë ditor duke përfshirë zhvillimin e aftësive profesionale dhe të rekreacionit.
2. Në hartimin e planit edukativ individual merret në konsideratë vlerësimi psikologjik, situata emocionale, niveli arsimor, dëshirat dhe mundësitë për të ndjekur kurse profesionale ose për të përparuar në arsimim.

Neni 11

Përzgjedhja dhe të drejtat e personelit mësimdhënës

1. Personeli mësimdhënës përzgjidhet në varësi të numrit të nxënësve, aftësisë së tyre për të punuar me të paraburgosurit dhe/ose të dënuarit e mitur dhe motivimit të tyre për të punuar me këtë kategori.
2. Personeli mësimdhënës përzgjidhet në përputhje me kriteret e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për sistemin arsimor parauniversitar dhe sipas procedurave të përcaktuara në aktet nënligjore për procedurat e lëvizjes paralele, emërimit dhe largimit nga puna të mësuesit në institucionet arsimore publike të sistemit arsimor parauniversitar.
3. Njësitë arsimore vendore përzgjedhin personelin mësimdhënës, sipas niveleve arsimore dhe sipas grup lëndëve të caktuara, nëpërmjet portalit “Mësues për Shqipërinë”.
4. Në fillim të çdo viti shkollor, drejtori i njësisë arsimore vendore dërgon zyrtarisht listën e personelit mësimdhënës te drejtuesi i institucionit të paraburgimit/IEVP-së përkatëse. Për çdo ndryshim të mundshëm të personelit mësimdhënës, drejtuesi i njësisë arsimore vendore lajmëron me shkrim drejtuesin e institucionit të paraburgimit/IEVP-së.
5. Pagesat e personelit mësimdhënës mbulohet nga buxheti i njësisë arsimore vendore pranë institucionit të paraburgimit/IEVP-së.
6. Transporti i personelit mësimdhënës në institucionin e paraburgimit/IEVP-së sigurohet dhe mbulohet nga buxheti i njësisë arsimore vendore edhe në rastet kur institucioni i paraburgimit/IEVP

ndodhet larg qendrave të banuara, në përputhje me përcaktimet e legjislacionit në fuqi.

Neni 12

Përgjegjësitë e personelit mësimdhënës

1. Procesi mësimor në mjediset e institucionit të paraburgimit/IEVP-së për të mitur zhvillohet sipas rregullave të parashikuara në legjislacionin në fuqi për sistemin arsimor parauniversitar.
2. Planet dhe programet mësimore për të miturit në klasat pranë institucionit të paraburgimit/IEVP-ve përgatiten nga institucioni përgjegjës për hartimin e planeve dhe programeve mësimore, në përputhje me objektivat e përgjithshme të parashikuara për arsimin parauniversitar dhe objektivat e posaçme që lidhen me proceset e riintegritimit dhe aftësimin të të miturit për të marrë një rol konstruktiv në shoqëri pas lirim.
3. Procesi mësimor për arsimin bazë në institucionet e paraburgimit/IEVP zhvillohet duke grupuar nxënësit në klasa të bashkuara, sipas grupmoshave përkatësisht në grupin e klasave I-III, IV-VI, VII-IX dhe X-XII.
4. Klasat në institucionet e paraburgimit/IEVP për të mitur varen nga institucioni arsimor që është pranë njësisë administrative të institucionit.
5. Drejtorja e institucionit arsimor që ka në varësi klasa në institucionet e paraburgimit/IEVP për të mitur përfshin në dokumentacionin bazë të institucionit arsimor gjithë nxënësit e këtyre klasave.
6. Personeli mësimdhënës që realizon procesin mësimor në institucionet e paraburgimit/IEVP caktohet nga radhët e mësuesve në organikën e institucionit arsimor publik që ka në varësi klasat në këto institucione.
7. Me qëllim matjen e efektivitetit të planit dhe programit mësimor të realizuar në institucionit të paraburgimit/IEVP në përfundim të çdo viti mësimor realizohet një vlerësim vjetor ose semestral. Vlerësimi i brendshëm bëhet nga institucioni arsimor përkatës, ndërsa vlerësimi i jashtëm realizohet përmes institucionit përgjegjës për inspektimin e sistemit arsimor parauniversitar. Mbajtja e të dhënave lidhur me frekuentimin dhe rezultatet është detyrë e personelit mësimdhënës.
8. Personeli mësimdhënës pranë institucioneve të paraburgimit/IEVP përfshihen në:

a) programet e trajnimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve për përgatitjen e tyre me njohuri të posaçme për të drejtat dhe liritë themelore të të miturit dhe standardet e drejtësisë penale për të miturit;

b) programet e edukimit dhe të kualifikimit të mëtijshëm profesional, të njëjta me programet për mësuesit e institucioneve arsimore publike në nivel kombëtar.

KREU IV

RREGULLAT E MBARËVAJTJES SË PROCESIT MËSIMOR

Neni 13

Ambienti dhe kushtet e zhvillimit të procesit mësimor

Drejtuesi i institucionit të paraburgimit/IEVP merr masa që mësimi të zhvillohet në mjedise të përshtatshme për mësimdhënie të organizuara sipas mundësisë në klasa, kushte të përshtatshme fizike të infrastrukturës përfshirë ndriçimin, higjienën dhe të pajisur me mjetet logjistike si banka, karrige, kënd emulacioni dhe mjete të tjera të nevojshme.

Neni 14

Pajisja e personelit mësimdhënës me autorizim

1. Personeli mësimdhënës që zhvillon procesin mësimor pranë institucionit të paraburgimit/IEVP, pajiset me autorizim në përputhje me rregullat në fuqi për hyrjen e punojësve të jashtëm që kryejnë punë në institucion.

2. Personeli mësimdhënës pajiset me autorizim të posaçëm nga drejtuesi i institucionit të paraburgimit/IEVP-së dhe paraqet për çdo hyrje dalje nga institucioni autorizimin e dhënë.

KREU V
EFEKTET E PROCESIT MËSIMOR DHE DOKUMENTACIONI

Neni 15

Efektet e procesit mësimor për të miturit në konflikt me ligjin

1. Përmbajtja e procesit mësimor për të miturin në konflikt me ligjin në institucionin e paraburgimit/IEVP janë të njëjta me ato të procesit mësimor që zhvillohet jashtë tyre.
2. Edukimi dhe aftësimi profesional i ofruar për të miturit në institucionin e paraburgimit/IEVP është i ngjashëm me atë të komunitetit që realizohet nga personel mësimdhënës/trajnues profesionistë.
3. Të miturit pajisen me dëftesa, diploma dhe/ose certifikata, pas përfundimit me sukses të procesit mësimor, njësoj si të miturit që ndjekin arsimin jashtë institucionit të paraburgimit/IEVP. Këto dokumente janë të barazvlefshme në formë e përmbajtje me dokumente të marra nga të mitur që nuk janë në konflikt me ligjin penal.

Neni 16

Konfidencialiteti i të dhënave lidhur me arsimimin

1. Dokumentet që vërtetojnë arsimimin e realizuar nga të paraburgosurit/të dënuarit e mitur/të rinj në periudhën kur ata kanë qenë të paraburgosur ose kur vuanin dënimin nuk duhet të përmbajnë informacion që bën të mundur identifikimin e të miturit si një ish i dënuar ose identifikimin e një dënimi të mëparshëm.
2. Dëftesat, diplomat dhe certifikatat e lëshuara nuk përmbajnë asnjë shenjë dhe asnjë të dhënë lidhur me institucionin e paraburgimit/IEVP ku i mituri ka kryer frekuentimin e vitit shkollor.
3. Ruajtja e të dhënave dhe transmetimi i tyre nga njëri institucion arsimor në tjetrin lidhur me procesin mësimor të të miturit është detyrë e drejtuesit të institucionit arsimor.
4. Aksesit në të dhënat e arsimit të të miturit është i garantuar sipas legjislacionit në fuqi që mbështetet në parimet e të drejtës së të miturve për privatësi dhe konfidencialitet.

Neni 17

Dokumentimi i kryerjes së procesit mësimor

1. Çdo mësues, mban dokumentacionin përkatës për të miturin në konflikt me ligjin që ka frekuentuar klasat brenda ose jashtë institucionit të paraburgimit/IEVP, sipas rregullave të parashikuara në nenin 16 të këtij urdhri.
2. Të dhënat përfundimtare hidhen në amzën e institucionit arsimor.
3. Në rastin e lirimit të të miturit, të dhënat lidhur me progresin në këto klasa i vihen në dispozicion institucionit arsimor ku i mituri do të ndjekë programin mësimor në gjendje të lirë jo më vonë se 7 (shtatë) ditë nga lirimi.

KREU VI

RREGULLA TË FUNDIT

Neni 18

Bashkëpunimi ndërinstitutional

1. Për zbatimin e këtyre rregullave midis drejtuesve të institucionit të paraburgimit/IEVP-së për të miturit dhe institucionit arsimor që do të ketë në varësi klasat mësimore brenda ose jashtë ambientit të institucionit të paraburgimit/IEVP-së, lidhet një marrëveshje bashkëpunimi.
2. Institucioni i paraburgimit/IEVP dhe institucioni arsimor me marrëveshje të përbashkët caktojnë një person përgjegjës dhe vendosin udhëzime të qarta e të detajuara lidhur me ndarjen e përgjegjësi, rregullat se si do të kryhet informimi në kohë i problematikave me qëllim bashkëpunimin për mbarëvajtjen e procesit mësimor.
3. Në këtë marrëveshje përcaktohen të detajuara elementët e procesit mësimor lidhur me:
 - a) regjistrimin në procesin mësimor brenda ose jashtë institucionit të paraburgimit/IEVP;
 - b) orarin mësimor ditë dhe javor,
 - c) orarin e paraqitjes dhe largimit të të miturit nga institucioni arsimor,
 - ç) intervalet mes orëve të mësimi,

- d) mbikqyrjen e të miturve në mjediset e institucionit arsimor,
 - dh) kohën e paraqitjes dhe largimit të personelit mësimdhënës dhe aksesin e tyre në mjediset e institucionit të paraburgimit/IEVP kur mësimi zhvillohet në të,
 - e) sigurimin e teksteve falas,
 - ë) pajisjen e klasave me bazë materiale dhe didaktike;
 - f) si dhe për elementë të tjerë që lidhen me zhvillimin dhe mbarëvajtjen e procesit mësimor.
4. Marrëveshja me shkrim përmban dhe përshkruan me detaje mënyrën e realizimit të planit dhe programit mësimor për të miturit.
5. Drejtuesi i institucionit të paraburgimit/IEVP-së merr masa që personeli i caktuar për mësimdhënie pranë institucionit të ketë akses të garantuar dhe të zhvillojë normalisht mësimin në institucionin e paraburgimit/IEVP.
6. Nga një kopje e marrëveshjes vendoset në dispozicion të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe njësisë arsimore vendore.

Neni 19

Realizimi i takimeve të përbashkëta dhe raportimi

1. Institucioni i paraburgimit/IEVP dhe njësitë arsimore vendore mbajnë komunikim interaktiv gjatë gjithë vitit shkollor dhe informojnë njëra-tjetrën për çdo problematikë.
2. Institucioni i paraburgimit/IEVP dhe njësitë arsimore vendore organizojnë jo më pak se 2 (dy) takime të përbashkëta në një vit shkollor me qëllim analizën e ecurisë së procesit dhe masat e nevojshme për t'u ndërmarre në vijimësi. Rendi dhe përfundimet e çdo takimi protokollohen në një dokument të posaçëm.
3. Institucioni i paraburgimit/IEVP dhe njësia arsimore vendore vlerësojnë bashkërisht funksionimin e bashkëpunimit nëpërmjet hartimit dhe paraqitjes së një raporti periodik me shkrim në përfundim të çdo viti shkollor. Raporti përmban të dhëna për procesin mësimor dhe rekomandime konkrete për adresimin e problematikave të evidentuara gjatë procesit mësimor.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E DREJTËSISË MINISTRI

URDHËR

Nr. 4950, Datë 02/05/2018

PËR PËRCAKTIMIN E FORMËS SË REGJISTRIT TË POSAÇËM TË MASËS ALTERNATIVE TË SHMANGIES NGA NDJEKJA PENALE, “PARALAJMËRIM ME GOJË”

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 e Kushtetutës, të nenit 66, pika 2 e ligjit nr. 37/2017, datë 30.03.2017 “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur” dhe të nenit 7, pika 2 të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar,

U R D H Ë R O J:

1. Forma e regjistrit të posaçëm të masës alternative të shmangies nga ndjekja penale ndaj të miturit në konflikt me ligjin “*Paralajmërimi me gojë*” (këtu e në vijim “*Regjistri*”) është sipas Aneksit bashkëlidhur këtij urdhri dhe që është përbërës i tij.
2. Çdo fletë e regjistrit është e ndarë në 11 (njëmbëdhjetë) kolona, me emërtimet e mëposhtme:
 - i) numri rendor;
 - ii) numri dhe data e kallëzimit/procedimit penal (sipas rastit);
 - iii) vendi i dhënies së paralajmërimit me gojë;
 - iv) gjeneralitetet e prokurorit/gjyqtarit që jep masën (emër, mbiemër);
 - v) gjeneralitetet e të miturit: emri, atësia, mbiemri, datëlindja, të dhënat e mjetit të identifikimit (nr. i çertifikatës apo i ndonjë

dokumenti tjetër);

vi) të dhënat e kujdestarit / përfaqësuesit ligjor / procedural / mbrojtësit / psikologut / përkthyesit / interpretit: emri, atësia, mbiemri, numri personal i identitetit dhe roli në proces;

vii) vepra penale e kryer, cilësimi i nenit dhe masa e dënimit të parashikuar në Kodin Penal;

viii) rrethanat individuale në lidhje me të miturin sipas nenit 22 të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur;

ix) shpjegimet e dhëna mbi dëmin e shkakuar dhe pasojat që rrjedhin nëse vepra penale përsëritet;

x) shënime ku pasqyrohen të dhëna specifike të ndonjë rrethane që lidhet me të miturin, referuar raportit individual sipas nenit 47 të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur;

xi) nënshkrimi i prokurorit/gjyqtarit që ka dhënë masën alternative të shmangies dhe i personit që administron regjistrin.

3. Në rast se bëhen gabime materiale në hedhjen e informacionit në regjistër, fjala e shkruar gabim nuk fshihet, por i vihet një vizë në mes në të gjithë gjatësinë e saj, futet në kllapa, duke vijuar të shkruhet informacioni i saktë dhe personi që bën korrigjimin bën shënimin “e korrigjuar” dhe nënshkruan në kolonën “Nënshkrimi”.

4. Përdorimi dhe aksesimi i të dhënave të të miturit që mbahen në regjistër kryhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

5. Për ruajtjen, përpunimin dhe administrimin e regjistrit zbatohen rregullat dhe procedurat e parashikuara nga legjislacioni në fuqi për arkivat.

6. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Drejtësisë për njoftimin e këtij urdhri Prokurorisë së Përgjithshme dhe gjykatave të shkallës së parë dhe të apelit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

Etilda Gjonaj (Saliu)

ANEKS

PROKURORIA/GJYKATA
Regjistri i posaçëm i masës alternative të shmangies nga ndjekja penale, “Paralajmërim me gojë”

Nr.	Nr. dhe data e kalëzimit/ së procedimit penal	Vendi i dhënies së paralajmërimit	Emri/Mbiemri i prokurorit/ gjyqtarit që jep masën	Gjeneralitetet e të miturit		Të dhënat e kujdestarit/parfaqësuesit ligjor/ procedural/mbrojtës/ psikologut/ përkthyesit/interpretit		Vepra penale e kryer	Bërhanat individuale që lidhen me të miturin	Shpjegimet e dhëna mbi dëmin e shkaktuar dhe pasojat që rrijnë nëse vepra penale përsëritet	Shënime	Nënshtkrimi
				Emri, Atësia, Mbiemri	Datëlindja	Të dhënat e mjetit të identifikimit	Emri, Atësia, Mbiemri	Nr. ID	Roli procedural			
1.												
2.												
3.												
4.												
5.												
6.												
7.												
8.												
9.												
10												
....												
....												



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E DREJTËSISË
MINISTRI**

URDHËR

Nr. 4951, Datë 02/05/2018

**PËR
MIRATIMIN E FORMATIT DHE TË DHËNAVE PËR MASËN
ALTERNATIVE TË SHMANGIES NGA NDJEKJA PENALE,
“PARALAJMËRIM ME SHKRIM”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 e Kushtetutës, të nenit 67, pika 3 e ligjit nr. 37/2017, datë 30.03.2017 “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur” dhe të nenit 7, pika 2 të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar,

U R D H Ë R O J:

1. Miratimin e formatit dhe të dhënave për masën alternative të shmangies nga ndjekja penale “Paralajmërim me shkrim” referuar modelit bashkëlidhur këtij urdhri dhe që është pjesë përbërëse e tij.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Drejtësisë për njoftimin e këtij urdhri Prokurorisë së Përgjithshme dhe gjykatave të shkallës së parë dhe të apelit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**MINISTRI
Etilda Gjonaj (Saliu)**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA/GJYKATA

Nr. _____ Prot. _____, më ____/____/201____

Masa alternative e shmangies nga ndjekja penale “Paralajmërim me shkrim”

(Procesverbal)

I) TË DHËNAT E FAKTIT TË KALLËZIMIT/PROCEDIMIT PENAL:

Prokuroria e Rrethit Gjyqësor/Gjykata e Rrethit Gjyqësor e përfaqësuar nga prokurori/gjyqtari _____ (emër dhe mbiemër), referuar kallëzimit/procesit penal nr _____, datë/viti _____, konstaton se në datë _____, ora _____ është paraqitur i mituri _____ (emër, atësi, mbiemër), i moshës _____, vendlindja _____, vendbanimi _____, i shoqëruar nga _____, në cilësinë e _____.

Rezulton e provuar se i mituri _____ ka kryer veprën penale _____, të parashikuar nga neni ____ i Kodit Penal, me masën e dënimit _____.

II. PËRSHKRIMI I KARAKTERISTIKAVE INDIVIDUALE TË TË MITURIT:

Mbështetur në raportin individual të të miturit, të përgatitur në bazë të rregullave të neneve 22 dhe 47 të Kodit të Drejtësisë Penale për të Miturit, sipas të cilit: _____

III. SHPJEGIMET QË I JEPEN TË MITURIT LIDHUR ME:

a) veprën penale të kryer sipas përcaktimit në Kodin Penal:

b) dëmin dhe rrezikshmërinë e veprës penale:

c) mënyrën dhe sjelljen ndaj veprës së kryer:

ç) pasojat e ardhura nga vepra penale e kryer që i janë shkaktuar viktimës/ave dhe komunitetit:

d) pasojat që vijnë nga fillimi i ndjekjes penale për veprën penale të kryer dhe pasojat e mundshme ndaj tij në rast të një dënimi penal:

dh) pasojat e mundshme në rast të përsëritjes së veprës penale dhe/ose të një vepre tjetër penale:

IV. ARSYETIMI I DOMOSDOSHMËRISË NË CAKTIMIN E MASËS ALTERNATIVE TË SHMANGIES “PALAJMËRIM ME SHKRIM”

Referuar rrethanave individuale dhe nevojave të të miturit dhe duke marrë në konsideratë dobishmërinë e masës alternative të shmangies për korrigjimin dhe riintegrimin e tij, arsyetoj se:

V. NËNSHKRIMET E PALËVE DHE TË PERSONAVE TË TJERË TË PRANISHËM

Prokurori/Gjyqtari

(Emër, Mbiemër).....

(Nënshkrimi).....

I mituri

(Emër, Mbiemër).....

(Nënshkrimi).....

Përfaqësuesi i familjes së të miturit

(Emër, Mbiemër).....

(Nënshkrimi).....

Persona të tjerë të pranishëm (kujdestari / përfaqësuesi ligjor/
procedural / mbrojtësi / psikologu / përkthyesi / interpreti apo
punonjës të tjerë të sistemit të drejtësisë për të mitur)

(Emër, Mbiemër).....

(Nënshkrimi).....

Vendi dhe data

.....

Ky procesverbal nënshkruhet në ____ kopje origjinale: një kopje
për të miturin dhe/ose _____ dhe një kopje për prokurorinë/
gjykatën.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E DREJTËSISË
MINISTRI**

URDHËR

Nr. 7639, Datë 5/7/2018

**PËR
MIRATIMIN E RREGULLAVE TË DETAJUARA PËR PËRDORIMIN
E SISTEMIT TË INTEGRUAR TË TË DHËNAVE TË DREJTËSISË
PENALE PËR TË MITUR NGA DREJTORIA E PËRGJITHSHME E
BURGJEVE DHE DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMIT TË
PROVËS**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 e Kushtetutës, të nenit 137 pika 5 të ligjit nr. 37/2017, datë 30.03.2017 “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur”, dhe të nenit 7, pika 2 të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar,

U R D H Ë R O J:

1. Sistemi i Integruar i të Dhënave të Drejtësisë Penale për të Mitur (më poshtë “Sistemi i Integruar”) plotësohet dhe përditësohet më të dhënat e përcaktuara në modulën përkatës nga:
 - a) punonjësit e seksioneve për të mitur në institucione të ekzekutimit të vendimeve penale ku i mituri i nënshtrohet masës së sigurimit “Arrest me burg”;
 - b) punonjësit e institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale ku i mituri është duke vuajtur dënimin me burgim;

- c) punonjësit e institucionit ku i mituri është duke vuajtur dënimin me kufizim lirie;
- ç) punonjësit e zyrave vendore të shërbimit të provës që mbikëqyrin:
 - i) zbatimin e masës alternative të shmangies nga dënimi;
 - ii) zbatimin e masës alternative të dënimit me burgim;
 - iii) zbatimin e dënimeve plotësuese kur ato jepen së bashku me dënimin kryesor me “gjobë”.
- 2. Sistemi i Integruar u vihet në dispozicion punonjësve të përcaktuar në pikën 1 të këtij urdhri në formatin web-based në faqen www.drejtisipertemitur.al pas dhënies së autorizimit me shkrim nga Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve dhe Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit të Provës, pas miratimit paraprak nga Ministria e Drejtësisë.
- 3. Sistemi i Integruar pasurohet nga punonjësi i autorizuar me të dhëna elektronike të përditësuara mbi çështjet penale ku përfshihet i mituri:
 - a) në cilësinë e personit të akuzuar për kryerjen e veprës/ave penale ndaj të cilit është caktuar masa e sigurimit “Arrest me burg”;
 - b) në cilësinë e të dënuarit për kryerjen e veprave penale duke pasqyruar fazën e ekzekutimit të vendimit të dënimit, duke përfshirë të dy llojet e dënimeve, me burgim dhe jo me burgim, si dhe dënimet kryesore dhe plotësuese, në kuptim të neneve 95 dhe 96 të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur.
- 4. Punonjësi i autorizuar plotëson dhe përditëson elektronikisht rubrikat e modulit përkatës brenda 24 (njëzet e katër) orëve nga koha e regjistrimit të çështjes dhe/apo urdhrit për ekzekutim, apo kryerjes së një veprimi procedural ndaj të miturit.
- 5. Kur periudha e dënimit ndaj të miturit përfundon, punonjësi i autorizuar reflekton dhe përditëson këtë të dhënë në Sistemin e Integruar.
- 6. Punonjësi i autorizuar është përgjegjës për saktësinë dhe përditësimin e të dhënave të hedhura prej tij.
- 7. Çdo punonjës i autorizuar ka hapësirën e tij të mbyllur në sistemin e ruajtjes së informacionit. Aksesit në këtë hapësirë është i ndaluar për përdorues të tjerë të të njëjtit nivel pa autorizimin e titullarit autorizues.
- 8. Punonjësi i autorizuar nuk mund të ndërhyjë dhe të ndryshojë rubrikat e moduleve të Sistemit të Integruar.

9. Punonjësi i autorizuar ka të drejtën e aksesit në Sistemin e Integruar vetëm për çështjen/et të autorizuara në ngarkim të tij dhe/ose që ndodhen në juridiksionin e institucionit e tij. Punonjësi i autorizuar në asnjë rast nuk ka të drejtë të ndajë të dhënat e Sistemit të Integruar të autorizuara në ngarkim të tij, pa autorizimin e titullarit autorizues.

10. Aksesit në Sistemin e Integruar sigurohet me emrin e punonjësit të autorizuar dhe fjalëkalimin përkatës, në përputhje me kredencialet personale të secilit punonjës. Emri dhe fjalëkalimi fillestar jepen në mënyrë konfidenciale në rrugë zyrtare nga Ministria e Drejtësisë, pas vënies në dispozicion nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës të të dhënave të punonjësit të autorizuar.

11. Sistemi ofron për çdo punonjës të autorizuar mundësinë e ndryshimit në çdo moment të fjalëkalimit dhe garanton ruajtjen e fshehtësisë së tij. Ruajtja dhe përdorimi i fjalëkalimit është nën përgjegjësinë vetjake të punonjësit të autorizuar.

12. Mekanizma të mbrojtjes së të dhënave nga aksesit i paautorizuar, të tilla si: fjalëkalimet, mekanizmi i fjalëkalimit, gjatësia e fjalëkalimit, periodiciteti i ndryshimit të fjalëkalimit, kufizimi i përsëritjes së fjalëkalimeve, përcaktohen nga struktura përgjegjëse e teknologjisë së informacionit pranë Ministrisë së Drejtësisë në manualin e përdorimit të Sistemit të Integruar.

13. Punonjësi i autorizuar njofton menjëherë dhe në asnjë rast jo më vonë se 24 (njëzet e katër) orë strukturën përgjegjëse për teknologjinë e informacionit pranë Ministrisë së Drejtësisë për çdo problem të hasur gjatë përdorimit të Sistemit të Integruar, duke kërkuar ekspertizë teknike për zgjidhjen e problemit.

14. Punonjësi i autorizuar hedh në Sistemin e Integruar të dhënat e të miturve të çështjeve të trajtuara nga data 1 janar 2018, sipas manualit të përdorimit të sistemit.

15. Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve dhe Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit të Provës kanë akses të plotë në të gjitha çështjet që janë në fazë ekzekutimi me qëllim mbikëqyrjen dhe monitorimin e përdorimit të Sistemit të Integruar nga punonjësit e autorizuar.

16. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës sigurojnë pjesëmarrjen e punonjësve të autorizuar në trajnimet e organizuara nga Ministria e Drejtësisë për përdorimin e Sistemit të Integruar.

17. Ngarkohet struktura përgjegjëse për çështjet e drejtësisë

penale për të miturit që në bashkëpunim me strukturën përgjegjëse të teknologjisë së informacionit pranë Ministrisë së Drejtësisë të hartojnë dhe të vënë në dispozicion të punonjësve të autorizuar manualin e përdorimit të Sistemit të Integruar, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga fillimi i funksionimit të sistemit.

18. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës që të vënë në dispozicion të strukturës përgjegjëse për çështjet e drejtësisë penale për të miturit në Ministrinë e Drejtësisë të dhënat e punonjësve të autorizuar për pajisjen e tyre me emrin dhe fjalëkalimin fillestar për aksesimin e Sistemit të Integruar jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga fillimi i funksionimit të sistemit.

19. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës për zbatimin e këtij urdhri.

20. Ngarkohet struktura përgjegjëse për çështjet e drejtësisë penale për të miturit pranë Ministrisë së Drejtësisë për njoftimin e këtij urdhri Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Provës.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet e tij pas vënies në funksionim të Sistemit të Integruar të të Dhënave të Drejtësisë Penale për të Mitur.

MINISTRI

Etilda Gjonaj (Saliu)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E DREJTËSISË
MINISTRI**

URDHËR

NR. 7641, DATË 5/07/2018

**PËR PËRCAKTIMIN E ELEMENTËVE TË MARRËVESHJES PËR
ZBATIMIN E MASËS SË SHMANGIES DHE/OSE NDËRMJETËSIMIN**

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës, të nenit 58, pika 4 të ligjit nr. 37/2017, datë 30.03.2017 “Për Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur”, të nenit 7, pika 2 të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar,

U R D H Ë R O J :

1. Elementët të marrëveshjes midis palëve për zbatimin e masës së shmangies nga ndjekja penale dhe/ose ndërmjetësimin (më poshtë “Marrëveshja”) janë:
 - a) palët e marrëveshjes;
 - b) objekti i marrëveshjes;
 - c) parimet nga të cilat udhëhiqet marrëdhënia ndërmjet palëve;
 - ç) të drejtat dhe detyrimet e palëve;
 - dh) programin e ndërmjetësimit dhe rregullat e zbatimit të tij;
 - d) përshkrimin e pasojave të mospërmbushjes së detyrimeve.
2. Palët në marrëveshjen për zbatimin e masës së shmangies janë:
 - a) i mituri, i cili duhet të japë pëlqimin personalisht ose nëpërmjet kujdestarit/përfaqësuesit ligjor apo procedural. Gjatë bisedimeve për shpjegimin e kuptimit të marrëveshjes dhe pasojave të saj dhe për dhënien e pëlqimit për lidhjen e

marrëveshjes, i mituri shoqërohet nga përfaqësuesi i tij ligjor, i cili nënshkruan bashkë me të. Në rast se përfaqësuesi ligjor konsiderohet i papërshtatshëm në raport me të miturin ose me procesin, i mituri do të shqërohet për dhënien e pëlqimit për lidhjen e marrëveshjes nga një përfaqësues procedural i caktuar nga organi kompetent.

b) prokurori i çështjes, i cili kryesisht ose me kërkesë të arsyetuar të palëve vendos mosfillimin e procedimit penal ose pushimin e tij për të miturin e akuzuar për kryerjen e një veprë penale.

3. Mbrojtësi i të miturit dhe psikologu marrin pjesë në bisedimet për lidhjen e marrëveshjes për vendosjen e masës së shmangies.

4. Objekti i marrëveshjes përcakton në mënyrë të detajuar:

a) përshkrimin e rrethanave të kryerjes së veprës penale;

b) llojin e masës së shmangies;

c) arsyen dhe qëllimin për të cilin prokurori i jep të miturit këtë masë;

ç) mënyra e zbatimit të masës nga i mituri.

5. Marrëveshja duhet të mbajë në konsideratë parimet e mëposhtme:

a) interesin më të lartë të të miturit që vlerësohet i lidhur me:

i) hartimin në një gjuhë të kuptueshme për të miturin;

ii) respektimin e mendimit të të miturit;

iii) mbrojtjen dhe kujdesin e të miturit për të garantuar mirëqenien e tij;

iv) shmangien e viktimizimit të dytë/të përsëritur të të miturit;

v) mirëbesimin dhe konfidencialitetin e të dhënave personale të të miturit;

b) vlerësimin e profilit të të miturit që vlerësohet i lidhur me:

i) rrezikshmërinë e veprës penale të kryer;

ii) dënimin e parashikuar për atë vepër;

iii) moshën e të miturit;

iv) shkallën e fajësisë;

v) dëmin e shkaktuar;

vi) efektin psikologjik për shkak të ndjekjes penale;

vii) qëndrimin e të miturit në lidhje me veprën penale të kryer dhe empatinë ndaj viktimës;

viii) sjelljen e të miturit pas kryerjes së veprës penale; si dhe

ix) raportin e vlerësimit individual;

c) qasjen ndërsektoriale në vlerësimin dhe përcaktimin e

interesit më të lartë të të miturit;

ç) shprehjen e vullnetit të lirë dhe të plotë të palëve;

d) ekuilibrin e drejtë dhe të sigurt të interesave private e personale me interesin publik.

6. Masat e shmangies dhe/ose ndërmjetësimit duhet të jenë të arsyeshme dhe në përputhje me moshën dhe me nevojat e të miturit autor dhe viktimë që garantojnë dhe synojnë mbrojtjen, edukimin, rehabilitimin dhe ri-integrimin e tyre,

7. Marrëveshja parashikon të drejtat dhe detyrimet e palëve sipas llojit dhe specifikës së masës së shmangies të negociuar ndërmjet palëve. Asnjë detyrim nuk mund t'i imponohet të miturit në procesin e vendosjes së masës së shmangies dhe/ose ndërmjetësimit, e cila mund t'i shkaktojë poshtërim, degradim, përjashtim nga procesi normal edukativ dhe/ose punësimi kryesor, si dhe dëmtim të shëndetit fizik dhe/ose mendor.

8. Programi i ndërmjetësimit hartohet dhe ndiqet nga ndërmjetësi i zgjedhur nga palët.

9. Programi i ndërmjetësimit mban në konsideratë:

a) natyrën e veprës penale;

b) historinë e të miturit;

c) mundësinë e kthimit të raporteve normale midis të miturit autor dhe viktimës;

ç) mundësinë e zvogëlimit të dëmit të viktimës;

d) mundësinë e rehabilitimit të të miturit dhe riintegrimin e tij në shoqëri;

dh) nevojën e përmirësimit të marrëdhënieve midis të miturit autor dhe viktimës së veprës penale.

10. Programi i ndërmjetësimit zhvillohet me pjesëmarrjen e të miturit autor të veprës penale dhe viktimës. Me pëlqimin e palëve, në programin e ndërmjetësimit mund të marrin pjesë përfaqësuesi ligjor i të miturit, psikologu, punonjësi i Njësisë për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës, prokurori dhe/ose personat e tjerë të caktuar prej tij.

11. Programi i ndërmjetësimit mund të përfshijë edhe ndërmjetësimin familjar, ku marrin pjesë bashkërisht me viktimën dhe të miturin autor, edhe të afërmit e tyre, persona nga rrethi i tyre shoqëror, përfaqësues nga agjenci publike për mbrojtjen e të miturve, mbikëqyrjen e tyre dhe parandalimin e kriminalitetit për të miturit. Në këtë rast programi i ndërmjetësimit përfshin mënyrën e kompensimit të dëmit dhe përmbushjes së detyrimeve që janë

të pranueshme prej viktimës dhe që pritet të mbajnë autorin larg situatave konfliktuale të ngjashme në të ardhmen.

12. Marrëveshja përmban përshkrimin e pasojave të mospërmbushjes së detyrimeve. Nëse i mituri nuk përmbush detyrimet e marrëveshjes punonjësi i shërbimit të provës ose ndërmjetësi informon me shkrim prokurorin, duke shpjeguar në mënyrë të detajuar kohën, vendin, mënyrën dhe rrethanat e mospërmbushjes dhe situatën personale të të miturit.

13. Për procedurën që ndiqet për mospërmbushjen e kushteve dhe detyrimeve që burojnë nga marrëveshja zbatohen parashikimet e nenit 72 të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur.

14. Ngarkohet struktura përgjegjëse për çështjet e drejtësisë për të miturit në Ministrinë e Drejtësisë për njoftimin e këtij urdhri Prokurorisë së Përgjithshme, Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Provës dhe Dhomës Kombëtare të Ndërmjetësve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

Etilda Gjonaj (Saliu)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E DREJTËSISË

MINISTRI

Nr. 5077/1 Prot.

URDHËR

NR. 367, DATË 15/07/2019

PËR

**MIRATIMIN E FORMATIT TË PLANIT INDIVIDUAL PËR PËRM-
BUSHJEN E DETYRIMIT TË KAKTUAR NGA GJYKATA PËR TË
MITURIN NË KONFLIKT ME LIGJIN**

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës, të nenit 7, pika 2 të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar, të pikës V, nënpika 8 të vendimit nr. 207, datë 10.4.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e autoriteteve kompetente dhe të procedurës që do të ndiqet për përmbushjen e detyrimeve të caktuara nga gjykata për të miturin në konflikt me ligjin”,

U R D H Ë R O J:

1. Miratimin e formatit të planit individual për të miturin në konflikt me ligjin, që do të zbatojnë autoritetet përgjegjëse për përmbushjen e detyrimeve të caktuara nga gjykata, sipas nenit 102 të Kodit të Drejtësisë Penale për të Miturit, sipas Aneksit bashkëlidhur këtij Urdhri dhe që është pjesë përbërëse e tij.
2. Për qëllime të këtij Urdhri, autoritetet përgjegjëse, kanë të njëjtin kuptim me atë të përcaktuar në pikën II, nënpika 1, të vendimit nr. 207, datë 10.4.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e autoriteteve kompetente dhe të procedurës që do të ndiqet për përmbushjen e detyrimeve të caktuara nga gjykata për të miturin në

konflikt me ligjin”.

3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për komunikimin e formatit të planit individual autoriteteve përgjegjëse, me qëllim orientimin e veprimtarisë së tyre gjatë miratimit të planit individual, sipas fushës përkatëse të përgjegjësisë.

4. Ngarkohet Drejtoria Rregullatore për Çështjet e Drejtësisë, për ndjekjen e procedurave të zbatimit të këtij Urdhri, për çështje për të cilat Ministria e Drejtësisë konsiderohet autoritet përgjegjës.

5. Ngarkohet Sektori i Arkiv-Protokollit për njoftimin e këtij Urdhri.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

Etilda Gjonaj (Saliu)

PLANI INDIVIDUAL

PËR

CAKTIMIN E MASAVE PËR PËRMBUSHJEN E DETYRIMEVE TË CAKTUARA NGA GJYKATA SIPAS NENIT 102 TË KODIT TË DREJTËSISË PENALE PËR TË MITUR

Në zbatim të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor _____, nr. _____ datë __/__/____, në të cilin urdhërohet përmbushja e detyrimit/detyrimeve:

_____, të parashikuar/a nga neni 102, pika 1, gërma __, i Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, nga i mituri (emër, atësi, mbiemër) _____, i moshës _____, vendlindja _____, vendbanimi _____, si dhe pasi është marrë paraprakisht:

a) Mendimi i të miturit, i cili deklaron se:

b) Mendimi i prindit të të miturit në konflikt me ligjin, i cili deklaron se:

Miratohet plani individual me këtë përmbajtje:

I. Masat që do të ndërmerren në përmbushje të vendimit të gjykatës

Bazuar në vlerësimin individual të të miturit, të bërë në bazë të rregullave të parashikuara nga nenet 22 dhe 47 të Kodit të Drejtësisë Penale për të Miturit nga ana e organit procedues si dhe mbështetur në të dhënat që kanë rezultuar nga:

- a) moshë e të miturit;
- b) gjendja mendore dhe emocionale;
- c) gjendja shëndetësore;
- d) nevojat e veçanta të tij;
- e) mënyra e jetesës dhe nevojat e të miturit, veçanërisht ato të lidhura me familjen;
- f) edukimi ose puna;
- g) motivet e kryerjes së veprës penale;
- h) qëndrimi pas kryerjes së veprës penale; si dhe
- i) rrethanat e tjera që kanë ndikuar në vendosjen e detyrimeve, sipas vendimit gjyqësor;

për përmbushjen e detyrimeve të vendosura nga gjykata, ndaj të miturit do të merren masat e mëposhtme:

II. Kohëzgjatja e masave përkatëse

Kohëzgjatja e masave të vendosura ndaj të miturit për qëllime të ekzekutimit të vendimit të gjykatës, në asnjë rast, nuk mund të kalojë kufijtë e caktuar në vendimin gjyqësor, që ka urdhëruar përmbushjen e detyrimit/detyrimeve përkatëse.

III. Caktimi i personit përgjegjës që do të mbajë komunikimet me prokurorinë dhe gjykatën

Nëse vendimi i gjykatës parashikon detyrimin periodik për raportim, për qëllime të raportimit mbi ecurinë e zbatimit të detyrimeve të vendosura për të miturin, caktohet si person përgjegjës Z./Znj. _____, me funksion _____.

IV. Bashkërendimi i veprimtarisë

Në kushtet kur gjykata ka caktuar për përmbushjen e detyrimit/detyrimeve, autoritetet e mëposhtme:

nëpërmjet komunikimit/komunikimeve me shkresën/shkresat _____, është dakordësuar bashkërendimi i veprimtarisë institucionale, për çështjet e mëposhtme:

V. Të drejtat dhe detyrimet e të miturit gjatë zbatimit të planit

Gjatë zbatimit të këtij plani, I mituri ka të drejtat dhe detyrimet e mëposhtme:

VI. Përgjegjësitë e Autoritetit përgjegjës gjatë zbatimit të planit

Autoriteti përgjegjës kujdeset për mbarëvajtjen e ekzekutimit të vendimit të gjykatës, në përputhje me urdhërimet e vendosura në vendimin gjyqësor dhe masat e përcaktuara në këtë plan, duke respektuar të drejtat e të miturit për zhvillim dhe mirëqenie sipas legjislacionit në fuqi.

Autoriteti përgjegjës ushtron funksionet e tij brenda fushës përkatëse të përgjegjësisë shtetërore dhe respekton bashkëpunimin ndërinstitucional me autoritetet e tjera sipas fushës së tyre të përgjegjësisë.

Për çdo pamundësi të ekzekutimit të vendimit gjyqësor, autoriteti përgjegjës detyrohet të raportojë pranë organit procedues dhe të ndjekë në vijim urdhërimet e mëtejshme të tij.

Ky plan, pasi është lexuar dhe kuptuar qartë nga palët e pranishme, pranohet dhe nënshkruhet prej tyre pa vërejtje.

AUTORITETI PËRGJEGJËS

I MITURI

(Institucioni)

(Emër Mbiemër)

(Nënshkrimi)

(Nënshkrimi)

PRINDI I TË MITURIT NË KONFLIKT ME LIGJIN

(Emër Mbiemër)

(Nënshkrimi)

PERSONA TË TJERË TË PRANISHËM

(kujdestari/përfaqësuesi ligjor/procedural/mbrojtësi/psikologu/përkthyesi/interpreti
apo punonjës të tjerë të sistemit të drejtësisë për të mitur

(Emër Mbiemër)

(Nënshkrimi)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E DREJTËSISË MINISTRI

Nr. 4754/2 Prot.

URDHËR

NR. 368, DATË 15/07/2019

PËR

MIRATIMIN E FORMATIT TË RAPORTIT PËR MOSPËRMBUSHJEN E MASËS ALTERNATIVE TË SHMANGIES NGA NDJEKJA PENALE E TË MITURVE NË KONFLIKT ME LIGJIN

